



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS -VUSHTRRI

PLANI I INTEGRITETIT I KOMUNËS SË VUSHTRRISË 2016 – 2019

QERSHOR 2016

H Y R J E

Plani i Integritetit i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016 – 2019 është një dokument bazë përmes të cilit synohet të arrihet luftimi i dukurive të korrupsionit.

Plani në fjalë është i hartuar dhe mbështetet në gjashtë shtylla kryesore: objektivat; qëllimi i aktivitetit; aktiviteti; bartësi i aktivitetit; afati dhe treguesit e suksesit.

Hartimi i këtij plani është bazuar në këto akte ligjore dhe nënligjore:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
2. Ligji Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit;
3. Ligji Nr. 04/L-051 për deklarimin e pasurisë;
4. Ligji Nr. 03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
5. Udhëzimi Administrativ Nr.02/2008 (MAP) për regjistrimin e dhuratave në institucionet e shërbimit civil të Republikës së Kosovës;
6. Udhëzim Administrativ Nr.02/12 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre;
7. Statuti Nr. 58/11 dt. 28.04.2011 i Komunës së Vushtrrisë.

Përmes këtij plani synohet që të rritet transparenca në të gjitha institucionet publike komunale, që të luftohet çdo mundësi e paraqitjes së situatave me elemente korruptive, që të vetëdijësohen dhe inkurajohen qytetarët për të raportuar rastet e korrupsionit, që të ngritet cilësia e menaxhimit të pronës komunale.

Parimet dhe vlerat

Vlen të theksohet se një luftë e suksesshme kundër korrupsionit ka nevojë për një mjedis të përshtatshëm shoqëror duke u bazuar në qeverisjen e mirë, parimet e shtetit të së drejtës, efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe përfshirjes së gjerë në luftën kundër korrupsionit në nivelin lokal, e cila ka për qëllim të arrijë efekte pozitive edhe në plotësimin e standardeve në rrugën për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Sundimi i ligjit përfshin një sërë rregullash të cilat zbatohen për të gjitha organet komunale të cilat kanë për qëllim respektimin dhe zbatimin e përgjegjësive dhe obligimeve ligjore të zyrtarëve në raport me legjislacionin në fuqi.

Efikasiteti, rregullat dhe burimet për rezultate, apo rezultatet që korrespondojnë me nevojat e shoqërisë.

Transparenca, do të thotë se vendimet janë bërë në përputhje me parimet, ligjet dhe rregullat në procesin e vendimmarrjes që ka për qëllim rritjen e informimit për publikun.

Reagimi, nënkupton se ekziston legjitimiteti i organeve përfaqësuese, institucioneve dhe organizatave në lidhje me llogarinë publike për veprimet e veta.

Gjithë përfshirja, nënkupton që vendimet e institucioneve komunale janë të bazuara dhe mundësojnë rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, që ka për qëllim shmangien dhe përjashtimin e mundësisë që individët të ndikojnë negativisht në vendimet që përfshijnë grupet apo qytetarët e komunës.

PRIORITETET

Plani i Integritetit mundëson identifikimin e fushave ku mund të ketë korrupsion dhe mungesë të përgjegjësisë/ llogaridhënies.

Me këtë dokument konsiderohet se është ndërtuar një plan i veprimit që ka për qëllim ndërtimin e integritetit (institucionet dhe qytetarët), krijimin dhe promovimin e luftës kundër korrupsionit, shtimin e njohurive, praktikave dhe mekanizmat për të forcuar luftën kundër korrupsionit, i cili kontribuon në zbulimin dhe dënimin e personave që kryejnë vepra penale të korrupsionit.

Prioriteti kryesor në institucionet e ndryshme komunale është që nëpërmes pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe institucionet kompetente të ndikojmë në ndryshime dhe rezultate të cilat shfaqin pamundësinë e veprimeve korruptive dhe ka një adresë të denoncimit të tyre, me qëllim që organet kompetente të veprojnë me forcën ligjit kundër veprimeve korruptive, dhe e cila mund të sjellë një praktikë të bashkëpunimit gjithëpërfshirës të institucioneve komunale dhe qytetarëve në luftën kundër korrupsionit.

Çështja e luftës kundër korrupsionit nuk është vetëm një çështje e vullnetit politik, por është një përgjegjësi më e gjerë që ka për qëllim përfshirjen e individëve dhe qytetarëve në nivelin komunal për të informuar dhe denoncuar tek organet kompetente çdo lloj elementi korruptiv, sidomos në nivelin politik dhe institucional, që do të thotë se çdo reduktim i përgjegjësisë ndaj aspektit politik dhe zyrtarëve të institucioneve komunale e zvogëlon potencialin për luftën kundër korrupsionit dhe njohjen e gjenezës së korrupsionit në shoqëri. Ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit bazohet në faktin se institucionet e komunës kanë siguruar kornizën ligjore për luftën kundër korrupsionit dhe legjitimitetin e luftës kundër korrupsionit.

Qëllimet për luftën kundër korrupsionit në nivelin komunal janë të interesit qytetar dhe institucional në nivelin komunal dhe që kanë për qëllim realizimin e objektivave të Planit të

integritetit të komunës, i cili kontribuon në rritjen e aktivitetit politik të qytetarëve nëpërmes pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e institucioneve demokratike, jo diskriminuese, efikase, të barabarta, për përmirësimin e komunikimit dhe besimit të qytetarëve ndaj organeve të qeverisjes lokale.

Gjithashtu qëllim tjetër në luftën kundër korrupsionit është ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës, ngritjes së vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve të qytetarëve dhe zyrtarëve të institucioneve komunale duke përfshirë: përmirësimin e zbatimit të ligjeve që rregullojnë luftën kundër korrupsionit, monitorimin e zbatimit të ligjeve që rregullojnë luftën kundër korrupsionit, krijimin e kornizës institucionale dhe normave për luftën kundër korrupsionit në nivelin komunal duke përfshirë qytetarët dhe shoqërinë civile, që ka për qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për luftën kundër korrupsionit në nivel komunal, i cili duhet të bëjë maksimumin që korrupsioni të jetë një fenomen marginal.

Të gjitha këto masa dhe hapa të planifikuara në Planin e Integritetit në Komunën e Vushtrrisë janë të lidhura me zhvillimin e infrastrukturës kundër korrupsionit, që kanë për qëllim të kontribuojnë për një mjedis më të mirë për luftën kundër korrupsionit, si dhe masat tjera kanë për qëllim zbatimin e tyre në periudhën kohore 2016-2019.

Në fokus të planit të integritetit janë: organet, institucionet e pushtetit lokal dhe zyrtarët, ndërmarrjet ku pushteti lokal ka të drejta të menaxhimit, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

Objektivat brenda të cilave përcaktohen masat dhe aktivitetet janë:

1. Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies;
2. Vetëdijesimi – inkurajimi dhe rritja e besimit të qytetarëve për raportimin e rasteve të korrupsionit;
3. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve komunale në luftën kundër korrupsionit;
4. Menaxhimi i pronës komunale konform legjislacionit në fuqi;
5. Identifikimi i rreziqeve të mundshme të menaxhimi i buxhetit të komunës;
6. Forcimi i kontrollit të menaxhimit të buxhetit të komunës dhe donacioneve;
7. Respektimi i rregullave dhe standardeve të ndërtimit në zonat e urbanizuara;
8. Krijimi i mekanizmit të ri lokal në luftën kundër korrupsionit;
9. Raporti vjetor kundër korrupsionit;
10. Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët e institucioneve dhe zyrtarët e lartë publik;
11. Sigurimi i masave të veçanta kundër korrupsionit në institucionet publike të komunës;
12. Forcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë në nivelin lokal (qeveri dhe kuvend) në relacion me nivelin qendror;
13. Rritja e nivelit të përgjegjësisë dhe profesionalizmit në punë të zyrtarëve të institucioneve të komunës;

14. Rishikimi i nivelit të të drejtave diskrecionare (të vendosjes vet në bazë të arsyetimit personal) të zyrtarëve institucional;
15. Ngritja e transparencës lidhur me pranimin e dhuratave të zyrtarëve të institucioneve publike.

PLANI I INTEGRITETIT I KOMUNËS SË VUSHTRRISË 2016 – 2019

Nr.	Objektivat	Aktiviteti	Bartës i aktivitetit	Afati	Treguesit e suksesit
1.	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies	1. Prokurimi online; 2. Ndërtimi i bashkëpunimit të qytetarëve, shoqërisë civile me organet e Komunës - instalimi i praktikës “karrigë e lirë” në kuvendin e komunës, e rezervuar për anëtarët e shoqërisë civile; 3. Instalimi i mekanizmit efikas për respektimin e gjëjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.	1. Drejtorja e Prokurimit; 2. Drejtoritë tjera të Komunës; 3. Institucionet arsimore dhe shëndetësore.	Korrik 2016 dhe në vazhdimësi	Numri (totali) i prokurimeve online
2.	Vetëdijësimi – inkurajimi dhe rritja e besimit të qytetarëve për raportimin e rasteve të korrupsionit	1. Fushatë vetëdijësimi për raportimin e rasteve të korrupsionit; 2. Organizimi i tryezave me qytetarë inkurajimin e paraqitjes	Zyra e komunikimit me publikun	Qershor 2016 dhe në vazhdimësi	1. Numri i rasteve të raportuara; 2. Numri i rekomandimeve të miratuara dhe të zbatuara

	<p>së rasteve të korrupsionit;</p> <p>3. Vendosja e posterëve në objekte të institucioneve publike dhe në vende të frekuentuara;</p> <p>4. Inkurajimi i qytetarëve për qasje në dokumente publike konform ligjeve në fuqi.</p> <p>5. Organizimi i përbashkët i punëtorive (seminareve) kundër korrupsion lidhur me keqpërdorimin e pasurisë publike;</p> <p>6. Krijimi i një formulari të të dhënave të rasteve të korrupsionit të raportuara dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente, të publikojë dhe të paragesë të dhënat e besueshme.</p>			
<p>3.</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të institucioneve komunale në luftën kundër korrupsionit</p>	<p>1. Organizimi i trajnimit për zyrtarët e lartë publik dhe të punësuarit – aplikimi i kodeve etike lidhur me parandalimin e korrupsionit;</p> <p>2. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike – komunale.</p>	<p>Zyra e Personelit</p>	<p>Qershor – Dhjetor 2016</p>	<p>Numri i të trajnuarëve</p>

<p>4. Menaxhimi i pronës komunale konform legjislacionit në fuqi</p>	<p>1. Krijimi dhe përditësimi i regjistrit të plotë të pronave komunale;</p> <p>2. Instalimi i mekanizmit efikas për zbatimin e gjejeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;</p> <p>3. Inventarizimi i pasurisë jofinanciare të komunës.</p>	<p>1. Zyra për menaxhimin e pronës komunale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë;</p> <p>2. Kryetari i komunës.</p>	<p>E përhershme</p>	<p>Regjistri i plotë i pronave komunale</p>
<p>5. Identifikimi i rreziqeve të mundshme të menaxhimi i buxhetit të komunës</p>	<p>1. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional;</p> <p>2. Përcjellja e implementimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit.</p>	<p>Auditori i Brendshëm i Komunës</p>	<p>Periodike</p>	<p>Numri i raporteve</p>
<p>6. Forcimi i kontrollit të menaxhimit të buxhetit të komunës dhe donacioneve</p>	<p>1. Auditimi i pasqyrave financiare;</p> <p>2. Publikimi periodik i projekteve përfshirë edhe fondin, aktivitetet për çdo projekt të financuar nga donatorët;</p> <p>3. Rritja e transparencës për financimin e qytetarëve dhe OJQ-ve nga grantet dhe subvencionet komunale.</p>	<p>1. Auditor i Përgjithshëm;</p> <p>2. Drejtoria për prokurime dhe zyrtari për donacione.</p>	<p>Vjetor</p>	<p>Raportet e auditimit</p>

7.	Respektimi i rregullave dhe standardeve të ndërtimit në zonat e urbanizuara	1. Të sigurohet kontroll i vazhdueshëm në terren lidhur me rregullat e ndërtimit; 2. Përfshirja më e madhe e qytetarëve në diskutime publike gjatë hartimit të planeve rregulluese; 3. Përfshirja e qytetarëve në diskutime publike për dhënien e kontributit të tyre për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) para dhënies së lejes mjedisorë për projektet që kanë ndikim në mjedis.	Inspektorët e ndërtimit	Raportimet të kryetari i komunës
8.	Krijimi i mekanizmit të ri lokal në luftën kundër korrupsionit	1. Formimi i Këshillit lokal kundër korrupsionit (KLIK), i përbërë: Kuvendi i Komunës, Qeveria Komunale, Policia, Gjykata, shoqëria civile, ekspert të fushës kundër korrupsionit dhe mediat; 2. Hartimi i Rregullores së punës së këshillit; 3. Hartimi i statistikave periodike të ecurisë së rasteve të korrupsionit.	Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës	Shtator 2016 1. Funksionimi i Këshillit; 2. Konstituimi i KLIK-së; 3. Rregullorja e aprovuar dhe plani i punës së KLIK-së.

9.	Raporti vjetor kundër korrupsionit	Hartimi i raportit vjetor dhe rekomandimet	Këshilli lokal kundër korrupsionit	Vjetore	Raporti
10.	Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët e institucioneve dhe zyrtarët e lartë publik;	<p>1. Shmangia nga vendimmarrja në konfliktin e interesit.</p> <p>2. Deklarimi i pasurisë të zyrtarëve të lartë publik siç janë: Kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive, zyrtari kryesor financiar, zyrtarët e Auditimit të Brendshëm dhe inspektorët;</p> <p>3. Deklarimi i pasurisë brenda mandatit të bëhet çdo vit nga data 01 deri në 31 mars;</p> <p>4. Deklarimi i pasurisë me rasiin e emërimit – zgjedhjes në postin publik të bëhet më së largu 30 ditë nga dita e emërimit – zgjedhjes;</p> <p>5. Deklarimi i pasurisë pas përfundimit të mandatit të zyrtarit publik të bëhet më së largu 30 ditë nga dita e përfundimit të mandatit;</p> <p>6. Pronari i ndërmarrjes –</p>	Zyra e Personelit	E përhershme	Numri i rasteve të parandaluara

	<p>biznesit në të cilin zyrtari i lartë publik ka pronësi apo pjesë të pronësisë, nuk ka të drejt të lidhë kontratë ose të përfillojë ndihmë nga institucioni i komunës, ku zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse;</p> <p>7. Institucionet komunale duhet të sigurojnë që:</p> <p>7.1. Zyrtari i lartë të mos jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private;</p> <p>7.2. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me prone publike, të mos ketë të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme;</p> <p>7.3. Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë pune nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, të mos mund të pranojë kompensim të shpenzimeve të udhëtimit dhe</p>			
--	---	--	--	--

	<p>shpenzimeve tjera te nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera;</p> <p>7.4. Zyrtari i lartë publik të mos ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse;</p> <p>7.5. Zyrtari i lartë publik te mos ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë se saj;</p> <p>7.6. Zyrtari i lartë i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për një vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve;</p> <p>8. Komuna duhet të sigurojë që nëpunësit civil dhe profesional të përfshihen nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes</p>			
--	---	--	--	--

		së tij kanë interes personal ose financiar.			
11.	Sigurimi i masave të vecanta kundër korrupsionit në institucionet publike të komunës	Inicimi në organet kompetente për rastet e dyshuara për korrupsion.	1. Organet kompetente; 2. Qytetarët.	E përhershme	Numri i rasteve të paraqitura.
12.	Forcimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë në nivelin lokal (qeveri dhe kuvend) në realacion me nivelin qendror.	1. Harmonizimi i veprimeve lidhur me vendimet që janë në interes për komunën dhe qytetarët; 2. Komunikimi në mes të pushtetit lokal dhe qendror në fushat e interesit të përbashkët.	Të gjitha institucionet e komunës.	E përhershme	Rezultatet e bashkëpunimit në mes të niveilit lokal dhe qendror.
13.	Rritja e nivelit të përgjegjesisë dhe profesionalizmit në punë të zyrtarëve të institucioneve të komunës	1. Monitorimi i procedurave të punësimit në bazë të meritave dhe raportimi i parregullsive në organet kompetente, veçanërisht gjatë procesit të rekrutimit; 2. Forcimi i rolit të komisionit për ankesa për nëpunësit civil; 3. Vlerësimi vjetor i punës së secilit zyrtar publik. 4. Organizimi i trajnimeve në fushën e menaxhimit dhe hetimit të korrupsionit brenda institucioneve të komunës;	1. Kryetari i Komunës; 2. Zyra e Personelit.	Për çdo fundvit	1. Raportimi i rregullt i monitorimit; 2. Numri i parregullsive të zbuluara (të gjetura) dhe të trajtuara; 3. Realizimi i planit të punës; 4. Numri i vlerësimeve me nota të dobëta dhe trajtimi i tyre; 5. Numri i trajnimeve.

		5. Luftimi i dukurisë së nepotizmit në të gjitha fushat.			
14.	Rishikimi i nivelit të të drejtave diskrecionare (të vendosjes vet në bazë të arsyetimit personal) të zyrtarëve institucional	Ngritja e nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjësisë në raport me detyrat e punës.	Të gjithë të punësuarit në sektorin publik në institucionet e komunës	E përhershme	Numri i rasteve eventuale të shmangies nga obligimet ligjore lidhur me kryerjen e detyrave të punës.
15.	Ngritja e transparencës lidhur me pranimin e dhuratave të zyrtarëve të institucioneve publike	Krijimi i regjistrit dhe katalogut të dhuratave	Zyra e Personelit	Pas aprovimit të këtij plani	Publikimi në faqe zyrtare të komunës

Për zbatimin e këtij plani kujdesen: kryetari i Komunës dhe drejtori kompetente të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova
 Kryesuesi i Kuvendit

